

ILVA GJUZI DACI

Ilva Gjuzi Daci ka lindur në vitin 1992 në Durrës.

Znj. Ilva Gjuzi është diplomuar në Universitetin e Kembrixhit për Arkitekturë në vitin 2014 pasi ka përfunduar studimet e shkollës së mesme në Kolegjin St'Andrews në qytetin e Kembrixhit me rezultate të shkëlqyera.

Znj. Gjuzi ka kryer gjithashtu studime Master në Universitetin Epoka në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike me profilizim në Politika Publike.

Prej vitit 2019 deri në 2024 është angazhuar si eksperte e zhvillimit të politikave për Turizëm të Qendrueshëm në kuadër të Strategjisë së Bashkimit European për Rajonin Adriatiko-Jonian.

Prej vitit 2017 deri në vitin 2019 znj. Gjuzi ka qenë pjesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban në Sektorin e Planifikimit Rajonal dhe Vendor dhe në vijim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit.

Në periudhën 2015 - 2017 znj. Gjuzi ka punuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit në njësinë Atelier Albania. Ajo ka qenë pjesë e ekipit organizativ të Edicionit të parë të Akademisë Verore Atelier Albania (AASA 2015) me fokus hartimin e një programi të qendrueshëm për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor në fshatrat malorë të Rivierës Shqiptare dhe në vijim është angazhuar në sektorin e bashkëpunimit mes AKPT-së dhe GIZ-it në programet me fokus zhvillimin e turizmit në Shqipëri.

Znj. Gjuzi posedon njohuri dhe eksperiencë të gjerë në ndërlidhjen e sektorit publik dhe privat të turizmit, pasi prej vitesh është e angazhuar në sipërmarrje private familjare në industrinë e turizmit dhe ndërtimit. Ajo është njohëse shumë e mirë e zinxhirit të ekonomisë së turizmit duke nisur nga fazat e hershme të konceptimit, projektimit dhe materializimit të strukturave akomoduese dhe potencialit të diversifikimit të ofertës turistike gjithëvjetore.

Prej shtatorit 2024 znj. Ilva Gjuzi është Nënkryetare e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste dhe njëherazi anëtare e Asemblesë së Partisë Socialiste të Tiranës.

Ilva Gjuzi ka qenë pjesë e Edicionit të I-rë të Akademisë Politike të Partisë Socialiste.

Znj. Gjuzi është e martuar dhe ka tre fëmijë.